Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**26.10.2023**	**01.11.2023**	**2023/0810**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.10.2023, OE "Horn & Co. Kosova SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0810, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Horn & Co. Kosova SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me targa per regjistrimin e automjeteve" me nr. të prokurimit: "214-22-12927-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0810 i dt:18.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Eshte shkelur neni 59., i Ligjit te Prokurimit Publik

- Eshte shkelur neni 27 dhe 28 , i Ligjit te Prokurimit Publik
- Eshte shkelur neni 72, i Ligjit te Prokurimit Publik
- Eshte shkelur neni 69, i Ligjit te Prokurimit Publik
- Eshte shkelur neni 1, 2, 6, dhe 7, i Ligjit te Prokurimit Publik

- Eshte shkelur neni 39, i Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik

- Eshte shkelur neni 3 dhe neni 3.1, i Dosjes se Tenderit

Konsorciumi Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', pas analizimit te teresishem te dokumenteve
relevante te Tenderit per: Furnizim me targa per regjistrim te automjeteve konstaton dhe konsideron se
Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME, ka bere shkelje ligjore ne mos
vleresimin e drejte, ligjor dhe objektiv te Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe Oferte e
pergjegjshme ne pajtim te plote me kerkesat, kushtet dhe kriteret e percaktuara ne Dosje te Tenderit.
Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues jane te prezentuara si vijon:
1. 1.Autoriteti Kontraktues, me daten 27/09 / 2023, ne per mjet portalit E-prokurimi te KRPP-se, publikon
Njoftim mbi vendimin e AK per dhanje te kontrates es per prokurimin: Furnizimi me targa per regjistrim te automjeteve;
2. Konsorciumi Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk, pas publikimit te Njoftim mbi vendimin
e AK per dhanje te kontrate, me daten 03.10.2023, ka pergaditur dhe dorezuar Kerkesen per
Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues.
Ne Kerkesen per Ri-shqyrtim, kemi listuar argumente te mjaftueshme ligjore dhe argumente teknike qe
Oferta e Konsorciumit Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk eshte Oferte e

pergjegjeshme dhe ne

pajtim me kerkesat, kushtet dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

Gjitheashtu, ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi ri-potencuar testet nga laboratoret teknike jane valide dhe

ligjore qe jane te akredituara nderkombetarisht dhe te githa keto teste si deshmi jane relavante dhe

argumente teknike qe deshmojne qarte se Targat qe do te prodhohen nga Konsorciumi jone i permbushin te

gjitha parametrat teknike te kerkuara dhe te cekura ne Aneksin 1 te Specifikimeve Teknike te Detyrueshme

dhe qe jane ne pajtim edhe me nenin 27 dhe nenin 28 te Ligjit te Prokurimit Publik, ku nje mall i caktuar

permban te gjitha elementet teknike, funksionalitet dhe performance ne prodhimin e tabelave per regjistrim

te automjeteve per Republiken e Kosoves.

Autoriteti Kontraktues, nese gjate procesit te vleresimit te ofertes sone ka pasur ndonje dyshim per testet

laboratorike te Kompanive testuese DEKRA dhe KURZ ose dyshim ne akreditim te tyre, ka mundur te beje

ekzaminim/verifikim tek Laboratoret gjegjes si DEKRA ose KURZ ose te marre sqarime shtese nga

Konsorciumi Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk por nje veprim te tille nuk e kane ndermarre edhe

pse kane obligim ligjor qe cdo Oferte te vleresojne, krahasojne dhe verifikojne ne aspektin teknik, ligjor dhe

financiar sipas nenit 59 dhe 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves;

3. Autoriteti Kontraktues, me daten 10/10/ 2023, ka dorezuar Vendimin per Refuzimin e

Kerkeses per

Rishqyrtim.

Ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, jep vetem konstatime te

pabazuara qe sipas mendimit te Konsorciumit tone, i mohohet e drejta e fitimit te kontrates publike ne

menyre te rregullte dhe ligjore per arsye se nuk jep asnje pergjigje ligjore ne te gjitha pikat tona

pretendimore ngase vetem ben 'kopjim' te arsyetimeve per eliminim te cekura ne Letren e Tenderuesit te

Eliminuar por nuk ofron pergjigje te drejteperdrejta ne Argumentet Ligjore me arsyetim ligjor te prezentuara

ne Kerkesen tone per Rishqyrtim edhe pse kane detyrim ligjor sipas nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit me

nr. 04 / L – 042 dhe sipas nenit 8 te Rregullave per parashtrim te ankesave;

4. Ne nderlidhshmeri, me piken 2 dhe 3 te Ankeses, Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova

shpk', do te dorezoje si Prove Materiale perseri te bashkengjitur Ankeses, Testimet e laboratorit

DEKRA Automobil GMBH por edhe informatat e nevojshme qe DEKRA eshte laborator i certifikuar nderkombetarisht duke perfshire edhe Laboratorin KURZ qe ben testimet e tabelave/targave te prodhuara nga UTSCH si pjese e Konsorciumit.

Laboratori DEKRA ka bere matjet dhe testimet per Konsorciumin ne pajtim te plote me standardet dhe

praktikat evropiane duke perfshire edhe rezultatet e laboratorit KURZ qe tregojne qarte qe parametrat

teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues per prodhimin dhe furnizimin me targa per

regjistrim te

automjeteve jane ne pajtim te plote me Aneks 1 te specifikacionave teknike te

detyrueshme, pjese perberese

e dosjes se tenderit.

Ne cdo kohe Autoriteti Kontraktues ka mundur te beje verifikim ose sqarim per rezultatet

e testimit dhe

deshmive te ofruara nga DEKRA ose KURZ (www.dekra.de ose www.kurz.de)

Prandaj, Autoriteti Kontraktues, sic kemi potencuar ne piken 2 dhe 3 te Ankeses kane

deshtuar te bejne

verifikim te drejteperdrejte te rezultateve te dy Laboratoreve per parametrat teknike dhe

matjeve te tabelave

qe do te furnizonte Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk' per nevojat e

Ministrise se

Puneve te Brendshme.

Duke mos bere verifikim profesional gjate procesit te vleresimit te ofertave ose per te

kerkuar sqarim per

keto ceshtje me Konsorciumin drejtperdrejte potencojme qe Autoriteti Kontraktues ka

shkelur rende nenin

59, 69 dhe nenin 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves dhe per kete arsye

konsiderojme se procesi i

vleresimit te ofertave ne pergjithesi ka qene subjektiv, jo ligjor dhe jo profesional.

5. Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', ne Oferte, ka dorezuar

DEKLARATEN

– Clarification on Provided Samples (sqarime lidhur me mostren e dorezuar) dhe

Deklaraten e

Specifikacionit Teknike, me te cilen e njofton dhe e paralajmeron Autoritetin Kontraktues

se pse

Tabela e dorezuar si MOSTER 01 – 999 – AD, nuk mund te perdoret per testime

laboratorike pasi e

njejta do te demtohej nga marrja e mostrave per testim.

Eshte me rendesi te potencohet se eshte e pamundur te prodhohet vetem nje Moster me te

gjitha elementet e

sigurise pa marre 'film sample' nga monopoli 3M per arsye se per te prodhuar MOSTER

me te gjitha

elementet e sigurise duhet pasur nje 'vellim te madh' dhe te caktuar te Tabelave dhe jo

vetem 1, ashtu

sic ka kerkuar Autoriteti Kontraktues.

Megjithate, sic ka kerkuar Autoriteti Kontraktues, ne piken 2 te FTD-se ka ofruar

MOSTREN me kualitetin

e materialeve, ashtu sic eshte kerkuar me Aneks 1 por pa masat e vecanta te sigurise si

shenja RKS ose data

e stampuar sepse nuk ka qene e obliguar te dorezohej, ashtu sic eshte cekur qarte ne piken

nr. 2 te Fletes

se te Dhenave te Tenderit – shih faqen 15.

Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', ne Oferte, ka dorezuar te

nenshkruar dhe te vulosur

Aneks 1 te Specifikacioneve Teknike te Detyrueshme, qe permban te gjitha 'parametrat'

teknik te

nevojshme per prodhim dhe furnizim te targave per regjistrim te automjeteve, ashtu sic ka

kerkuar Autoriteti

Kontraktues ne Dosje te Tenderit dhe ne Aneks 1 te Specifikacioneve Teknike.

Eshte me rendesi te potencojme qe KURZ eshte prodhues i shtreses me stampim te

nxehte (hot stamping

foil) te targave per regjistrimi te automjeteve dhe nuk eshte institut i testimit. Gjitheashtu,

potencojme se

askund ne Evrope dhe gjetiu nuk ekziston ndonje Institut i posaqem per stampim te

shtreses se nxehte, ashtu

sic kerkon Autoriteti Kontraktues.

Ne anen tjeter, instituti DEKRA eshte institut i akredituar zyrtarisht qe ben testimin

mekanike dhe teknike te

testeve ne metale dhe plastike sipas standardeve nderkombetare, DIN EN ISO 17025:

2018 dhe shume

standardeve tjera. Pra, DEKRA eshte i autorizuar te beje testime per targa te regjistrimit

te automjeteve dhe

shume lloje tjera te testimeve.

Shih ne fakte te bashkengjitura dokumentet qe argumentojne punen dhe pergjegjesite e

DEKRA si

institucion i autorizuar nderkombetare per testime.

Dokumentet e ofruara nga DEKRA dhe KURZ tregojne procesin dhe metoden e prodhimit

ne pajtim me

nenin 28 (specifikacionet teknike) qe demonstrojne qe produktet e ofruara nga

Konsorciumi jone jane

plotesisht funksionale dhe performuese, ashtu sic ka kerkuar Autoriteti Kontraktues me

specifikacionet

teknike te detyrueshme sipas Aneks 1 te Dosjes se Tenderit.

1. Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', ri-thekson se sa i perket Mostres se shenjave

drejtuese te sigurise ku

shirtat e zi duhet te posedojne shenjen RKS eshte e rendesishme te ri-potencojme se e njejta

kerkese/moster nuk eshte e

obligueshme qe te i kene masat e vecanta te sigurise por duhet vetem te jene ne harmoni me kualitetin e

materialeve

sipas specifikimit teknik te detyrueshem, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit.

Po ashtu, e kundershtojme, Autoritetin Kontraktues, kur potencon se data e porosise te jete e stampuar

ne anen e prapme ngase kjo kerkese specifike nuk parasheh te permbaje masat e vecanta te sigurise

por duhet te jene ne harmoni me kualitetin e materialeve sipas specifikimit teknik te detyrueshem,

Aneks 1 te Dosjes se Tenderit.

Keto kerkesa te potencuara per te cilat nga raporti i forenzikes eshte eliminuar padrejtesisht oferta jone por

edhe nga anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave eshte theksuar ne FTD (faqe 15 te Dosjes se

Tenderit – FTD) pasi qe ne menyre specifike ceket se nuk jane te obligueshme te dorezohen por vetem

te mirren parasysh kualiteti i materialeve sipas Aneks 1.

Si pjese te argumenteve ligjore dhe teknike, ne Ankese, do te dorezohen kopjet e faqes 15 te FTD, pjese e

dosjes se tenderit per te konstatuar ne aspektin ligjor qe Konsorciumi me rastin e pergaditjes dhe

dorezimit te Ofertes i eshte permbajtur ne teresi KERKESAVE SPECIFIKE DHE TEKNIKE te

cekura ne Dosje te Tenderit gjegjesisht Fletes se te Dhenave te Tenderit kur eshte prodhuar dhe

dorezuar MOSTRA tek Autoriteti Kontraktues.

Prandaj, Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk' ka ofruar dhe dorezuar me Oferte te gjitha

dokumentet e kerkuara / deshmite / certifikatat si dhe MOSTREN per vleresim dhe testim nga Autoriteti

relevant ne Kosove qe eshte bere nga ekipi inxhinierik dhe profesional i Konsorciumit ne pajtim te

plote me te dhenat e kerkuara teknike, ashtu sic eshte prezentuar ne Aneks 1 te Specifikimeve

Teknike te Detyrueshme dhe qe eshte ne pajtim edhe me piken 10 te Aneks 1 te ketyre

Specifikacioneve sa i perket materialeve, prapavijes me fije te bardhe, shtrese me stampim te nxehte,

alumin dhe Mostrat sipas standardeve evropiane dhe standardave nderkombetare;

7. Ne nderlidhshmeri, me piken 6 te Ankeses, Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk',

e konteston 'sqarimin' e ofruar nga zyrtaret e Autoritetit Kontraktues ne pyetjet e

parashtruara nga Ofertuesit potencial per arsye se pergjigja e tyre ne piken kontestuese nr. 2 te

Fletes se te Dhenave te Tenderit eshte kunderligjore sa i perket dorezimit te Mostres me dimensione

520 x 110 mm ku ceket shprehimisht ... citat: Mostra nuk eshte e obligueshme qe te i kene masat e

vecanta te sigurise por duhet te jene ne harmoni me kualitetin e materialeve per prodhimin e

targave sipas specifikacioneve teknike te dhena ne Aneks 1 te Dosjes se Tenderit ..... mbyllje

citati.

Mirepo, ne sqarimet e Autoritetit Kontraktues per ofertesuesit potencial te dates 05 mars 2023, per piken kontestuese nr.2 te FTD-se cek se nuk pranohet asnje Moster pa i pasur 'masat e vecanta' te sigurise ?.

Ky sqarim konfuz eshte teresisht jo-ligjore dhe ne kundershtim te plote me Kerkesat Specifike te potencuara ne faqen 15 te Fletes se te Dhenave te Tenderit, nenit 39 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik dhe nenit 27 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr.04 / L – 042 per arsye se cdo 'sqarim' i tenderit per natyren e kerkesave specifike qe ka kerkuar Autoriteti Kontraktues duhet te jete ne pajtim me keto Kerkesa dhe JO ne kundershtim te plote dhe ne kete menyre te krijoje konfuzitet dhe te jete 'argument i paqendrueshem ligjor' ne eliminimin e Ofertes sone.

Eshte e palejueshme dhe jo ligjore qe nje sqarim per tenderuesit potencial te ndryshoje permbatjen e Kerkesave Specifike Teknike qe jane cekur ne Fleten e te Dhenave te Tenderit me Ligjin e Prokurimit Publik.

Eksperti Teknik Shqyrtues por edhe anetaret e panelit shqyrtues te OSHP-se mund te shoshit dhe te vertetojne qe veprimi i anetareve te komisionit per vleresimin e ofertave dhe Departamentit te Prokurimit ne Ministri te Puneve te Brendshem per ceshtjen e sqarimit te gabuar ne pyetjet e ofertesueve potencial per piken nr.2 te Fletes se te Dhenave te Tenderit eshte kunderligjor dhe ne kundershtim te plote me Kerkesat Specifike te percaktuara ne FTD.

Edhe pse sqarimi i ofruar nga Autoriteti Kontraktues i dates 05 mars 2023 eshte ne kundershtim me Kerkesat Specifike te Fletes se te Dhenave te Tenderit, Konsorcumi jone, ka pasur besim qe Autoriteti Kontraktues do te beje vleresim te drejte dhe profesional dhe do te beje korrigjimin e gabimit te tyre teknik

gjate procesit te vleresimit te ofertave.

Prandaj, per shkak gabimit profesional ne ofrim te sqarimeve qe jane ne kundershtim me vet Kerkesat e specifikuara ne Dosje te Tenderit qe ka rezultuar me refuzim te Ofertes, jemi te detyruar ne parashtrim te Kerkeses per Rishqyrtim dhe Ankeses ne Organin Shqyrtues te Prokurimit.

Si rredhoje, Oferta jone nepermjet MOSTRES se dorezuar eshte valide dhe ligjore ngase permban parametrat teknik, ashtu sic ka kerkuar Autoriteti Kontraktues ne piken nr.2 te FTD-se qe Mostra nuk eshte e obligueshme te i kene Masat e Vecanta te Sigurise por duhet te jene ne harmoni me kualitetin e materialeve per prodhimin e targave sipas specikacioneve teknike te dhena ne Aneks 1 te Dosjes se Tenderit;

8 Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje ligjore te nenit 27, 28 dhe nenit 69 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 dhe nenit 39 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik per arsye se vleresimi i Ofertueseve behet 'eksluzivisht' kundrejt KERKESAVE qe jane te specifikuara ne Fleten e te Dhenave te Dosjes se Tenderit dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme dhe ne aftesite teknike dhe profesionale te Prodhuesit te targave per regjistrim te automjeteve.

Sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042, Autoriteti Kontraktues, gjate procesit te vleresimit te ofertave ka obligim ligjor qe te vleresoje, krahasoje dhe ekzaminoje Oferten e Konsorciumit

'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk' ne cdo aspekt teknik, ligjor dhe financiar.

Ne rastin konkret, anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave, nuk kane bere 'ekzaminim' te Ofertes

sone kundrejt specifikacionit teknik te detyrueshem, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit sepse 'verifikimi' ka

qene i domosdoshem per te ardhur ne konstatim ligjor qe Oferta e Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co

Kosova shpk' eshte Oferte e pergjegjshme dhe ne pajtueshmeri te plote me kerkesat teknike te potencuara ne

Dosje te Tenderit.

Me 'ekzaminim' nenkuptojme 'verifikim' te gjendjes faktike dhe si rrjedhoje procesi i vleresimit te ofertes

sone nga Autoriteti Kontraktues eshte Jo-ligjor, subjektiv dhe Jo profesional.

Si rezultat i saj, edhe njehere ri-potencojme se Oferta e Konsorciumit 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova

shpk' eshte e Oferte e pergjegjeshme, performuese dhe produktet e ofruara me Oferte jane plotesisht

funksionale, ashtu sic kerkohet me nenin 27 dhe nenit 28 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe ashtu sic

kerkohet me Specifikacionet Teknike te Detyrueshme, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit dhe nuk do te paraqiste

asnje problem gjate implementimit te kontrates publike per 'prodhim dhe furnizim te vazhdueshem' me

targa per regjistrim te automjeteve per Republiken e Kosoves; dhe

9. Autoriteti Kontraktues, ka shkelur edhe nenin 1, 2, 6 dhe 7 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 /

L – 042 ngase po diskriminohet rende Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', ne

mos vleresimin e drejte dhe ligjore te ofertes sone te pergjegjeshme nga ana e komisionit vleresues
te Autoritetit Kontraktues dhe me vendimin e Refuzimit te Kerkeses per Rishqyrtim, pasi si
Ofertues kemi ofertuar me cmimin me te lire dhe qe kursehet buxheti i Kosoves ne vlere prej
673,953.53 Euro.
Mos kursimi i vleres financiare prej 673,953.53 Euro nga mos perzgjedhja e Konsorciumit tone si
fitues te tenderit pervec qe ben shkelje ligjore te te gjitha dispozitave ligjore te potencuara me Ankese te
Ligjit te Prokurimit Publik ben edhe shkelje ligjore te Ligjit te Menaxhimit te Financave Publike ngase
me keto 2 Ligje te miratuara nga Qeveria e Kosoves ne menyre specifike dhe ligjore potencohet qe pas nje
procesi konkurrues te drejte dhe pas plotesimit te te gjitha kushteve dhe kritereve nga Operatori Ekonomik
te behet nenshkrimi i kontrates publike dhe te filloje procesi i implementimit te kontrates.
Ne kete drejtim, Konsorciumi 'Eric Utsch AG, Horn & Co Kosova shpk', garanton per cilesine e produktit
qe ri-konfirmon qe produkti i ofruar ne Oferten tone eshte ne pajtim te plote me specifikacionet teknike te
detyueshme te dosjes se tenderit (pjese e specifikacionit teknik te detyrueshem) dhe nuk ka asnje ndikim ne
performancen dhe funksionalitetin e produktit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktues.
Nese Autoriteti Kontraktues, ka pasur ndonje veretje qe Oferta jone mund te kete pasur ndonje devjim te
vogel atehere eshte dashur te zbatoje dhe aplikoje nenin 59.4 te Ligjit te Prokurimit Publik

ngase oferta jone

i permbush ne teresi te gjitha kushtet dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues dhe ka oferte

me te lire kundrejt

konkurrenteve te tjere me ane te se ciles kursehen 673,953.53 Euro poqese Oferta jone

perzgjidhet nga

Autoriteti Kontraktues per implementim te kontrates publike.

Si perfundim, ri-potencojme se perfaqesuesit e Konsorciumit 'Eric Utsch AG, Horn &

Co Kosova shpk'

jane ne dispozicion per te ofruar sqarime profesionale teknike si per Ekspertin Teknik te

OSHP-se por edhe

per anetaret e OSHP-se gjate shqyrtimit te argumenteve tona ligjore me spjegime konkrete

ligjore dhe

teknike ne menyre qe te bindet Paneli Shqyrtues ne shkeljet ligjore te Autoritetit

Kontraktues per refuzim te

Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe Oferte e pergjegjeshme ne pajtueshmeri te

plote me kerkesat

dhe kushtet teknike te potencuara ne Dosjen e Tenderit.

Shenim per argumentet ligjore te potencuara ne Ankese dhe faktet e bashkengjitura:

Ne pajtim me Rregulloren per Trajtimin e Ankesave dhe sic parashihet edhe me nenin 108 / A te Ligjit te

Prokurimit Publik pretendimet ankimore jane te njejta ku si parashtrues i Ankeses kemi ofruar arsyetimet

tona ligjore dhe mos pajtimet ne arsyetimet e ofruara ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Risqyrtim

kundrejt argumenteve ligjore te potencuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.

Ne parashtrim te Ankeses ne OSHP bejme edhe deponimin e provave relevante materiale me numer rendor

per te i ofruar argumente te mjaftueshme ligjore si Ekspertit teknik shqyrtues por edhe anetareve te Panelit

Shqyrtues te OSHP-se per te konstatuar drejte dhe ligjshem gjendjen faktike per lenden e kontestuar.

Perfaqesuesit ligjor ose Perfaqesuesi Teknik (inxhinier te Kompanise), si parashtrues te Ankeses ne

OSHP

jane ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punes se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 / A te Ligjit te

Prokurimit Publik, te ofroje sqarime ligjore lidhur me permbajten e argumenteve tona ligjore dhe teknike

(provat) potencuara ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues poqese kerkohen sqarime lidhur me

permbatjen e Ankeses.

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: a.Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).
		b.Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	b.Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vertetimit nga administrata tatimore, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.
		c.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se	c.Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i

			tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë" për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, i cili duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vërtetimin nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës.	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).
		b.Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	b.Certifikata e TVSH-së (kopje).	
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar a.Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor financiar i OE i realizuar në tri vitet e shkuara 2019-2020-2021 kanë qenë jo me pak se 3,000,000.00 €.	*Dështmia e kërkuar dokumentare:* a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës (kopje).	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional	*Dështmia e kërkuar dokumentare:*	

			1.Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të kenë kontratë/a të përfunduara me sukses për furnizim me targa për regjistrim të automjeteve, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 500,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	1. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).
			2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit.	2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike- MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në një zarf të mbyllur.
			3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)

			4. Laboratori/institute i cili leshon test raportin sipas kerkesen ne nenin 9.1 & 9.2 te pikes 3, duhet te jete i akredituar nga institucionet perkatse dhe te jete i pranuar/antarsuar së paku një nga këto organizatat: - Kooperimi Evropian për Akreditim (EA) - Kooperimi ndërkombëtar laboratorik për akreditim (ILAC) - Forumi ndërkombëtar për akreditim (IAF).	4. Çertifikatë ose dokument tjetër dëshmues (kopje) *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
			5.Dëshmi me të cilën dëshmohet që folia dhe ngjyra e shkronjave është kompatibile në pajtim me ISO 7591.	5. Çertifikatë ose dokument tjetër dëshmues (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*).
			6.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 7591 për prodhimin e targave retro-reflektive për automjete motorike dhe rimorkio (Retro-reflective registration plates for motor vehicles and trailers).	6. Certifikatën valide ISO Standard 7591 (kopje)
			7.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 9001 për menaxhim cilësor te sistemeve (Quality manage systems)	7.Çertifikatë valide ISO 9001 (kopje)
			8.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 14001 për Sistemet e menaxhimit mjedisor (Environmental management systems).	8.Çertifikatë valide ISO 14001 (kopje)
			9. Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 27001 për menaxhim te sigurisë se informacionit (Information security management).	9. Çertifikatë valide ISO 27001 (kopje)
	Ankesat	32.3	Shëno adresën e AK-së. Referoju nenin 1.1 ne FTD	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK)

- Komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se për kërkesën dhe dëshminë nr. 3 ju keni prezantuar një test laborator me numër 0628/1895266884/21 nga DEKRA, ky test raport **nuk ka të evidentuar qe janë bëre matjet (testimi) për mostren 01-999-AD** siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023, gjithashtu ne test raport nuk ka rezultatet pozitive kërkesat ne piken 10 të Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME te DT, andaj ky test raport nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023.

Ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 përveç tjerave është kërkuar:

Alumin	Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar.	Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.

Lidhur me këtë Test Raport nga Laboratori, ju keni dorëzuar-prezantuar një Technical Specification nga KURZ por nuk kemi as një dëshmi qe KURZ është Laborator apo institut i akredituar për matje (testim) siç është kërkuar ne dosje te tenderit (*sipas verifikimeve ne internet Kurz nuk figuron qe është Laborator apo institut i akredituar për matje).*

- Komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se tenderuesi nuk ka paraqitur – dorëzuar mostrat e targave në përputhshmëri me specifikimet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe sqarimeve te dt. 05.01.2023.

Komisioni i ri-vlerësimit, ka konstatuar se mostra me shifër (666) e dorëzuar nga tenderuesi Grup i OE, "Erich Utsch" AG & "Horn & Co. Kosova" SH.P.K nuk i përmbushin kërkesat sipas specifikimet teknike dhe sqarimeve te dt. 05.01.2023, te paraqitura gjeni ne tabelë pikat te cilat nuk janë përmbushura nga tenderuesi si vijon:

Kërkesa sipas specifikimit teknik ne dosjes se tenderit, Aneksi 1		Verifikimi i mostrës nga komisioni rivlerësues
4.1 Shenjat drejtuese te sigurisë	Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre	Nuk posedon shenjën RKS
4.2.Data e porosis	Në brendësinë e targës në anën e prapme të jetë data e porosisë.	Nuk posedon datën e porosis ne anën e prapme

prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta Juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_____, _____

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Horn & Co. Kosova SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar test raportin në pajtim me ISO 7591 sipas kërkesave të dosjes nuk e ka të evidentuar se është bërë testim për targat 01 999 AD, nuk është evidentuar Alumin EN AË 1050 H42 ose EN AË 1200 H42.

Po ashtu sipas AK-së komisioni rivlerësues ka konstatuar se mostra e OE nuk mban datën e porosisë dhe shiritat me ngjyrë të zezë nuk mbajnë shenjën RKS të përsëritur periodikisht.

Pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur se i njëjti ka ofruar test raport nga Dekra në pajtim me ISO 7591, megjithatë në këtë test raport nuk ka inmformata qfar targe është testuar apo per ku është e dedikuar, përveq të dhënave si në vijim :

Subject matter of the order:	Inspection of number plates "UTSCH Sonderprüfung" according DIN 74069 and ISO 7591

Mendimi ekspertit është se në rastin konkret AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga anëtari i hrpit Eric UTSCH si dhe nga laboratori testues.

Ndërsa mungesa e evidentimit Alumin EN AË 1050 ose 1200 H42 nuk nënkupton automatikisht se targa nuk e punuar nga materiali i lartcekur.

Sa i përket mungesës së datës së porosisë, sipas raportit të fakultetit mostra 666 mban datën e porosisë.

Ndërsa sa i përket arsyes se mungon shenja RKS në mënyrë të përsëritur në shiritat e zi, nëse shiritat janë pjesë e masave të sigurisë, atëherë vlerësojmë se kjo nuk mund të përdoret si arsye e eliminimit,

pasi përmes dosjes është përcaktuar se m "*.Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë...*".

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe rekomandojmë qe me rastin eventual të rivlerësimit të kërkohen informata/sqarime shtesë nga OE ankues duke pas parasysh se OE është dukshëm me çmim të ulët në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Horn & Co. Kosova SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA